

Data 08.04.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje e sistemit të fiskalizimit si dhe integrimi ndërmjet sistemeve të OSHEE GROUP SH.A për një periudhë 3 vjecare”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- 72260000-5 -
*Shërbimet e lidhura me softwaret.***

VLERA E FONDIT LIMIT: -50,066,468 (pesëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) All, pa TVSH, ose 504,549.7 (peseqind e kater mijë e pesëqind e dyzet e nëntë pikë shtatë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 08.04.2025, 1 euro = 99.23 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme, sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike, duke bere te mundur vetem Upgrade, zgjerim dhe permiresim te sistemit aktual. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën **jo më pak se vlera e fondit limit**.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatorëve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrencësmerisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 35 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshëm) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare:

- 1) **ISO 9001** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- 2) **ISO 27001** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- 3) **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Argumenti: Certifikimi ISO 9001:2015 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese. Ky çertifikim kërkohet në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rëndësinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group sh.a ka në përdorim;

Certifikimi ISO 27001:2022 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendesi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këto kontrate do të ketë edhe përdorim të aplikacioneve të reja për diagnostikimin e elementeve të sigurisë së sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim. Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group shpall ka në përdorim;

Certifikimi ISO 20001-1:2011 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group shpall ka në përdorim;

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar nga AKSHI dhe DPT për :

- a. Prodhues dhe/ose Mirëmbajtës i zgjidhjes software-ike për fiskalizimin e faturës (me para në dorë dhe pa para në dorë);
- b. Prodhues dhe/ose Mirëmbajtës i zgjidhjes softëare-ike për fiskalizimin e faturaës shoqëruese ;
- c. Prodhues dhe/ose Mirëmbajtës i zgjidhjes softëare-ike për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike.

Certifikimi të jetë publikuar te “lista-e-subjekteve-te-certifikuara” në : tatimo@gov.al.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë partner i certifikuar i sistemit financiar ekzistues (referuar specifikimeve teknike/kerkesat teknike) në Shqipëri. Ky fakt vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së certifikatës së partneritetit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht: Certifikata e partneritetit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së licensave/suporteve specifike të garancisë që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikepamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre licensave/suporteve specifike të garancisë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve bashkëkohore nga prodhues me famë të mirë botërore dhe të zyrtarizuar në praktikë të tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE

ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vertetuar se disponojnë autorizimet perkatese për furnizimin e licensave/suporteve specifike të garancise, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët perkates si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qene se nje pjese e prokurimit eshte per sitemin ekzistuese qe eshte funksionale, kane akoma rendesi dhe vlere materiale te konsiderueshme per AK, atehere kerkohet siguri nga OE qe te vertetoje lidhjen e tij me Prodhuesin/Distributorin perkates te kanalit zyrtar, ne menyre qe te kene te drejta per te rishitur keto licensa/suporte garancie, ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia e procesit nga te njejtet prodhues. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshem teknik të kualifikuar me kualifikimet e duhura, si më poshtë :

a. 1 (nje) specialistë të certifikuar për Menaxhim Projektsh ose ekuivalente.

Argumenti: Per kriterin ne piken a) certifikimi për menaxhim projektsh eshte një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit të suportit gjatë implementimit, në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të Autoritetit Kontraktor. Duke pasur nje punonjës të certifikuar për menaxhim projektsh, operatori ekonomik tregon përkushtim ndaj cilësisë dhe menaxhimit të shërbimeve IT në përputhje me standardet me te mira. Kjo ndihmon në sigurimin e një menaxhimi efektiv dhe të strukturuar të shërbimeve, duke përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e ofruar.

b. 1 (një) punonjes për analize proceseve të punës të Biznesit dhe menaxhim projekti;

Argumenti: Analiza e proceseve të punës dhe menaxhimi i projekteve janë elementë thelbësorë për funksionimin e suksesshëm të një operatori ekonomik. Një punonjës i dedikuar për këtë rol ndihmon në optimizimin e burimeve, përcaktimin e objektivave dhe sigurimin e përmbushjes së detyrimeve brenda afateve dhe standardeve të kërkuara. Një punonjës i specializuar në analizën e proceseve të punës identifikon mundësitë për përmirësim, shmang humbjet e panevojshme të kohës dhe burimeve dhe rrit produktivitetin. Kjo ndihmon në optimizimin e rrjedhës së punës dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve apo produkteve që ofron operatori ekonomik. Vendosija e një punonjësi të specializuar për analizën e proceseve të biznesit dhe menaxhimin e projekteve është thelbësore për një operator ekonomik që synon të funksionojë në mënyrë të organizuar dhe efikase. Kjo ndihmon në përmirësimin e performancës së përgjithshme, sigurimin e cilësisë dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale në mënyrë efektive.

c. 1 (nje) punonjes te certifikuar per administrim database te sistemit ekzistues financiar - SAP ose ekuivalente.

Argumenti: Sistemet financiare si **SAP** ose ekuivalentët e tij janë platforma të avancuara që menaxhojnë transaksione financiare, kontabilitetin dhe burimet e organizatës. Një administrator i certifikuar për

databazën e këtyre sistemeve garanton që të dhënat financiare të organizatës të jenë të sakta, të përditësuara dhe të aksesueshme në mënyrë të sigurt. Sistemet financiare përmbajnë informacion të ndjeshëm mbi të ardhurat, shpenzimet, faturat dhe raportet financiare. Një administrator i kualifikuar siguron që këto të dhëna të ruhen në mënyrë të sigurt, të jenë të mbrojtura nga akseset e paautorizuara dhe të minimizohet rreziku i gabimeve në përpunimin e tyre. Vendosija e

një administratori të certifikuar për bazën e të dhënave të sistemit financiar SAP ose ekuivalent është një kërkesë thelbësore për të garantuar sigurinë, integritetin dhe efikasitetin e menaxhimit të të dhënave financiare. Ky rol ndihmon në shmangien e gabimeve, rritjen e performancës së sistemit dhe përpunueshmërinë me rregullat dhe standardet financiare ndërkombëtare.

d. 1 (një) punonjes te certifikuar per Business Process Integration me sistemin financiar SAP ose ekuivalente.

***Argumenti:** Integrimi i duhur i proceseve të biznesit me sistemin financiar ndihmon në **automatizimin e operacioneve**, reduktimin e kohës së përpunimit dhe uljen e gabimeve manuale. Një specialist i certifikuar në këtë fushë është i aftë të konfigurujë sistemin për të siguruar një rrjedhë të efektshme dhe të optimizuar të informacionit midis moduleve të ndryshme të SAP ose një sistemi ekuivalent. Nëse proceset e biznesit nuk janë të integruara siç duhet me sistemin financiar, mund të ketë probleme si **mospërputhje të të dhënave, vonesa në raportim ose gabime në llogaritje financiare**. Një ekspert i certifikuar garanton që të dhënat të përpunohen dhe të transmetohen saktë midis departamenteve të ndryshme. Integrimi i proceseve të biznesit me sistemin financiar duhet të përmbushë kërkesat **ligjore dhe rregullatore** të sektorëve të ndryshëm (si ligjet tatimore, standardet e kontabilitetit si IFRS dhe GAAP). Një specialist i certifikuar ka njohuritë për të siguruar që sistemi i integruar respekton këto kërkesa. Kërkesa për një punonjës të certifikuar në **Business Process Integration me sistemin financiar SAP ose ekuivalent** është e domosdoshme për të **garantuar funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të sistemit financiar të një organizate**. Ky specialist ndihmon në **automatizimin e proceseve, rritjen e saktësisë së të dhënave dhe përmirësimin e vendimmarrjes**, duke e bërë sistemin më të besueshëm dhe më të përpunueshëm me rregulloret.*

Një punonjës mund të disponojë një ose më shumë se një certifikim.

Për të vërtetuar disponimin e stafit te mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata përkatëse/ Diplomat.
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, (duke marrë si reference data e hapjes se ofertave).
- Kontratën/at e punës konform legjislacionit në fuqi të lidhura me stafin e kerkuar dhe CV-në.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet

edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.